



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEĆA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-04/IA004

Vendosi: Kryetarja e Dhomave të Specializuara
Gjykatëse Ekaterina Trendafilova

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 2 dhjetor 2021

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Vendim për Caktimin e Panelit të Gjykatës së Apelit

Gjykatësve të Panelit të Gjykatës së Apelit:

Gjykatëse Mishelë Pikar

Gjykatës Emilio Gati

Gjykatëse Nina Jorgensen

Zyrës së Prokurorit të Specializuar:

Xhek Smith

Mbrojtjes së Pjetër Shalës:

Zhan-Lui Zhilisen

KRYETARJA e Dhomave të Specializuara (“Kryetarja”), duke marrë parasysht nenet 33(1)(c), 45(2) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar, rregullat 77, 169 dhe 170(2) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës dhe rregullat 3 dhe 4 të Rregullores për Caktimin e Gjykatësve të Dhomave të Specializuara nga Regjistri i Gjykatësve Ndërkombëtarë (“Rregullorja për Caktimin e Gjykatësve”), me anë të këtij vendimi cakton një panel të Gjykatës së Apelit në vijim të vendimit të Gjykatës të Procedurës Paraprake më të cilin i miratoi, pjesërisht, z. Pjetër Shala leje për apelimin e Vendimit mbi Mocionin e Mbrojtjes për Mangësi në Formën e Aktakuzës (“Vendimi për Miratimin e Lejes për Apelim”).¹

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 18 tetor 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake nxori Vendimin e Kundërshtuar.
2. Më 26 tetor 2021, z. Shala kërkoi leje për apelimin e Vendimit të Kundërshtuar.²
3. Më 29 nëntor 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake miratoi, pjesërisht, kërkesën e z. Shala për leje për apelimin e Vendimit të Kundërshtuar.³

II. CAKTIMI

4. Pas shqyrtimit të kriterëve të përcaktuara në rregullën 4 të Rregullores për Caktimin e Gjykatësve, duke përfshirë përvojën dhe kompetencën përkatëse, si edhe disponueshmërinë në këtë moment,

¹ F00116, Vendim mbi Kërkesën për Leje për Apelim të Vendimit mbi Mocionin e Mbrojtjes për Mangësi në Formën e Aktakuzës, 29 nëntor 2021; F00089/RED, Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Mocionin e Mbrojtjes për Mangësi në Formën e Aktakuzës, 18 tetor 2021 (“Vendimi i Kundërshtuar”).

² F00094, Kërkesë e Mbrojtjes për Leje për Apelim të Vendimit mbi Mocionin e Mbrojtjes për Mangësi në Formën e Aktakuzës, 26 tetor 2021 (konfidenciale).

³ Shih Vendimin për Miratimin e Lejes për Apelim, para. 31.

KRYETARJA ME KËTË VENDIM ÇAKTON

Gjykatësen Mishelë Pikar

Gjykatësin Emilio Gati

Gjykatësen Nina Jorgensen

në Panelin e Gjykatës së Apelit për të vendosur në lidhje me apelin në përputhje me
Vendimin për Miratimin e Lejes për Apelim

/nënshkrimi/

Gjykatëse Ekaterina Trendafilova
Kryetare e Dhomave të Specializuara

E enjte, 2 dhjetor 2021
Hagë,
Holandë